



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRII

Numri i lëndës: 2021:277225

Datë: 27.09.2024

Numri i dokumentit: 06221756

P.nr.329/23

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA VUSHTRII - Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Besart Prishtina, në çështjen penale kundër të pandehurit B.M. nga Vushtria, me vendbanim në Prishtinë, për shkak të veprës penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm, PP.II.nr.835/21, të datës 08.12.2023 të ri kualifikuar nga gjykata në veprën penale, Vjedhja e rëndë nga neni 315 paragrafi 1 pika 1.1, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik të datës 24.09.2024, në praninë e Prokurores së shtetit Viryte Gërvalla, të pandehurit B.M. dhe mbrojtësit me autorizim sipas detyrës zyrtare K.C. të zëvendësuar nga Av. R.M. dhe të dëmtuarve E.M., Z.RR.M. dhe dëshmitarit E.LL., pas shpalljes së aktgjykimit me datë 24.09.2024, me datë 27.09.2024, nxjerr, këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI:

B.M., nga i ati Sh., e ëma N., e gjinisë S., data e lindjes..., në Prishtinë me vendbanim në Prishtinë, me numër personal ..., i pa punë, i martuar, baba i një fëmije, i gjendjes së dobët ekonomike, ka të kryer shkollën mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, edhe më parë i gjykuar për vepra të kësaj natyre dhe natyrave të tjera.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Më datë 13.03.2021, rreth orës 19:00, në rrugën “Bastri Beqiri”, nr. 24, Vushtri, saktësisht në shtëpinë e të dëmtuarit E.M., i pandehuri me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete, në atë mënyrë që kishte kaluar nga muri – garazhda afër shtëpisë kishte kaluar në ballkonin e katit të dytë, ku me forcë hap derën e ballkonit depërton brenda në shtëpi për të vazhduar në katin e tretë, me ç ‘rast demolojnë të gjitha orenditë dhe nga aty marrin arin e bashkëshortes – të dëmtuarës Z.RR.M. dhe nënës së të dëmtuarit E.M..

- Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 315, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat e nenit 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 46, 47, 48, 69, 70, dhe nenit 315 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të KPRK-së si dhe nenit 364, 449, 452 dhe 462 të KPPK-së, të pandehurin B.M., e

G J Y K O N

DËNIM ME BURGIM në kohëzgjatje prej katër (4) vite e gjashtë (6) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet 15 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi si dhe DËNIM ME GJOBË në shumë prej pesëmijë euro (5,000,00 Euro) i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës verifikuese në kohëzgjatje prej 5 viteve.

Pala e dëmtuar E.M. dhe Z.RR.M. për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohen në kontest të rregullt civil.

DETYROHET i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej njëqind euro (100.00 Euro).

DETYROHET i pandehuri që në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej njëzet euro (20 Euro).

Të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP.II.nr.835/21, të datës 08.12.2023, kundër të pandehurit B.M. nga Vushtrria, me vendbanim në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Av. D.I. me seli të zyrës në Vushtrri, për shkak të veprës penale Vjedhja e rëndë nga neni 315, paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 të KPRK-së.

Gjykata me datën 23.04.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilën i pandehuri nuk e ka pranuar fajësinë, e në të cilën i njëjti është udhëzuar për të drejtat e tij për të paraqitur kundërshtimet e provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës.

Mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i të pandehurit, Av. K.C., me datën 30.04.2024 ka paraqitur kundërshtimin e provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës. Prokuroria Themelore Mitrovicë, me datën 14.05.2024, ka paraqitur përgjigje në kundërshtimet dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës.

Gjykata, me aktvendimin P.nr.329/23, të datës 21.05.2024 ka refuzuar si të pabazuara kundërshtimet e provave dhe kërkesën për hedhjen e aktakuzës të paraqitura nga mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i të pandehurit

Kundër aktvendimit P.nr.329/23, të datës 21.05.2024, mbrojtësi sipas detyrës zyrtare i të pandehurit, ka paraqitur ankesë për Gjykatën e Apelit. Prokuroria e Apelit, i ka propozuar Gjykatës së Apelit që ankesën e mbrojtësit të të pandehurit t'a refuzoj si të pabazuar.

Gjykata e Apelit me aktvendimin PN.DP.929/2024, të datës 02.07.2024 ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të të pandehurit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega Vushtrri P.nr.329/23, të datës 21.05.2024.

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datën 24.09.2024, i pandehuri është deklaruar i pafajshëm dhe palët i kanë paraqitur fjalët hyrëse, është bërë administrimi i provave materiale dhe pasi që palët nuk kanë pasur ndonjë propozim për plotësimin e provave. I pandehuri B.M. ka zgjedhur që të deklarohet duke mohuar kryerjen e kësaj vepre penale dhe pas kësaj palët i kanë paraqitur fjalët përfundimtare.

Pretendimet e palëve gjatë shqyrtimit gjyqësor

Prokurori i shtetit në fjalën hyrëse ka deklaruar se gjatë shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale do të vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë dhe atë në bazë të provave të propozuara si në aktakuzë, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar, pas administrimit të të gjitha provave u vërtetua përtej dyshimit të bazuar mirë se i pandehuri B.M. e ka kryer veprën penale që i vihet në barrë, pra atë të Vjedhjes së rëndë dhe fakti se kjo vjedhje kualifikohet si vjedhje e rëndë, mbështetet në dy elemente, atë të tejkalimit të pengesave si dhe hapjen me forcë të derës, ballkonit nga ku edhe ka depërtuar brenda, nga dëgjimi i dy dëshmitarëve të cilët njëkohësisht e kanë edhe statusin e palës së dëmtuar u vërtetua që ditën kritike në shtëpinë e tyre ka ndodhur vjedhja, ku fakti se të njëjtëve i është vjedhur ari, respektivisht se të njëjtit i kanë poseduar ato, e vërteton edhe foto dokumentacioni në shkresat e lëndës, ku nga palët janë dorëzuar disa fotografi ku tregojnë vendosjen e arit, i cili është vjedhur ditën kritike, nga fotografitë në shkresat e lëndës dhe atë fotografia nr.8, në faqen 5 të foto albumit, shihet dera e ballkonit e cila është hapur me forcë dhe nga e cila është depërtuar brenda, nga dëgjimi i dëshmitarit sot në seancë gjyqësore u vërtetua se te lokali i tij, konkretisht auto larja “Mema” janë shikuar video incizimet sipas raportit të datës 24.03.2021, ku njëri prej punëtorëve të tij ka deklaruar se ditën kritike e ka parë të pandehurin në afërsi të vendit ku ka ndodhur vjedhja dhe se të njëjtin e njezh shumë mirë, çka ky deklarim i dëshmitarit ka fuqi shumë të lartë provuese pasi që përveç që i njëjti e pohon këtë fakt, ky deklarim legjitimohet edhe nga dy hetuesit sherif Osmani dhe Arsim Kabashi të cilët kanë përpiluar raport, e që ky raport është në plotëni në përputhje me deklarin e këtij dëshmitari, nga video incizimi i marrë nga kamerat e shtëpisë të XH.K., shihet i pandehuri duke kaluar në drejtim të banesave në drejtim të shtëpisë së të dëmtuarit, e që kjo përcjellje e lëvizjes së tij vërtetohet edhe nga kamerat e tjera që janë administruar is provë nga shkresat e lëndës. Sa i përket mbrojtjes së të pandehurit, kjo si e tillë, po ashtu e vërteton akuzën e PSH, për shkak se është në tërësi kundërthënëse, me vetë deklaratën e tij dhënë në fazën e hetimeve e të cilin deklarim e ka bërë pasi që i janë lexuar të gjitha të drejtat e tij në procedurë dhe në prezencë të mbrojtësit, ku i pandehuri nuk e kundërshton nënshkrim e tij e as deklarin e tij, ndërsa në deklaratën e dhënë në shqyrtimin gjyqësor i njëjti jep deklaratë të ndryshuar lidhur me kalimin e tij nga shteti i Kosovës në shtetin tjetër ku thotë

se ka kaluar ilegalisht. Të gjitha këto prova që u elaboruar përfshirë edhe mbrojtjen e tij, te mbrojtja në kuptimin që i njëjti nuk mund të provojë alibinë e tij se ka qenë jashtë Kosovës, sepse këtë e vërtetojnë edhe nga informatat e pranuar nga Sistemi për Menaxhimin Kufitar të datës 30.10.2023, ku figuron se i njëjti ka një hyrje – dalje me datë 09.03.2021, çka pa as një mëdyshje e vërteton faktin se i njëjti ka qenë në Kosovë, dhe në mbështetje të provave tjera vërtetohet aktakuza e PSH përtej dyshimit të bazuar mirë, andaj edhe gjykatës i kërkoi që të njëjtin ta shpallë fajtorë, e nëse i njëjti edhe më herët është dënuar me vendime të formës së prerë për vepra të tilla penale ti shqiptohet maksimumi i dënimit me burgim, kjo në aplikim të faktit se është recidivist dhe si i tillë paraqet edhe rrezik për shoqërinë, mirëpo edhe tregon faktin se i njëjti nuk ka arritur të rehabilitohet në kuptim të qëllimit të dënimit. Rrethana lehtësuese në këtë çështje penale nuk ka, andaj gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit nëse të njëjtin e gjen fajtor, i kërkoi që të ketë parasysh rrethanat e lartcekura.

I dëmtuari i pari E.M. në hyrëse ka deklaruar se e përkrah fjalën e prokurorit të shtetit si dhe kërkon kompensim dëmi lidhur me këtë çështje penale, ndërsa fjalën përfundimtare ka deklaruar: E mbështesë fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit.

E dëmtuara e dytë Z.RR.M. në hyrëse ka deklaruar se e përkrah fjalën e prokurorit të shtetit si dhe kërkon kompensim dëmi lidhur me këtë çështje penale, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar: E mbështesë fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe kërkoj kompensim dëmi.

Av. mbrojtës i të pandehurit në fjalën hyrëse ka deklaruarës pas administrimit të provave do të vërtetohet nëse i mbroturi im ka kryer veprën penale, ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar, se i mbrojturi im gjatë kësaj seance, gjatë administrimit të provave deklaroi se për veprën penale për të cilën është ngarkuar në dispozitiv të akuzës, gjoja se me datë 13.03.2021 rreth orës 19:00, i njëjti ka deklaruar se në këtë kohë nuk kam qenë në Kosovë, por jashtë vendit, gjithashtu edhe nga deklarata e të dëmtuarve E.M. dhe Z.RR.M., te njëjtit në seancë deklaruan se të mbrojturin tim nuk e njohin. Prandaj duke u bazuar në këto deklarata dhe prova të cilat gjykata do të vlerësojë propozojë gjykatës që të mbrojturin tim ta lirojë nga akuza.

I pandehuri në fjalën hyrëse dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar: E mbështesë fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim.

Provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor

Gjykata me rastin e mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në pajtim me nenin 7 të KPPK-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit në pajtim me ligjin, më vëmendje të plotë dhe me përkushtim profesional dhe me përkujdesje vërtetoi faktet kundër të akuzuarit si dhe faktet në favor të tij duke i mundësuar të akuzuarit, shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të tij, në vazhdim janë të shtjelluara provat e administruara, përfshirë:

Provat personale

Marrja në pyetje në cilësinë e dëshmitarit, e të dëmtuarit të parë E.M. në seancën e datës 24.09.2024, i cili ka deklaruar se në ditën kritike ka qenë në punë dhe në kohën kur ka ndodhur ngjarja në shtëpi nuk ka qenë askush. Tutje ka shtuar se në shtëpi, në kohën kur ka ndodhur ngjarja ka jetuar me nënën e tij, bashkëshorten dhe 2 fëmijët e tyre. I njëjti ka shtuar se për ngjarjen është njoftuar në telefon nga bashkëshortja, nuk e di orën e saktë por e di se ka qenë pasdite, pothuajse natë. I njëjti ka deklaruar se me të arritur në shtëpi, para shtëpisë ka qenë bashkëshortja e tij dhe policia, me të hyrë brenda ka parë dhomën e fjetjes dhe dhomën e nënës së tij që kanë qenë rrëmujë sepse rrobat kanë qenë në dysheme, dhe dollapët kanë qenë të hapur, ndërsa dhoma e fëmijëve nuk i kujtohet se në çfarë gjendje ka qenë. Lidhur me sendet që kanë munguar në shtëpi i njëjti ka deklaruar se është njoftuar nga bashkëshortja sepse të gjitha kanë qenë dhurata nga martesja dhe kanë qenë në dhomën e fjetjes në katin e tretë, ndërsa në dhomën e nënës së tij është marrë një rreth i dorës i arit. Lidhur me të pandehurin i njëjti ka deklaruar se nuk e njeh dhe nuk e ka njohur më parë, ndërsa vëllezërit e tij e kanë njohur prindin – babain e të pandehurit, por që nuk kanë raporte familjare, ndërsa as i dëmtuari dhe as vëllezërit e tij nuk kanë pasur ndonjë kontakt personal as me të pandehurin e as me familjarët e tij.

Marrja në pyetje në cilësinë e dëshmitares, e të dëmtuarës së dytë Z.RR.M. në seancën e datës 24.09.2024, e cila ka deklaruar se qëndron në tërësi pran deklaratës së dhënë në polici me datën 13.03.2021 duke shtuar se e njëjta ka qenë personi i parë që ka arritur në shtëpi pasi që ka ndodhur rasti dhe dera poshtë, e hyrjes ka qenë e mbyllur ndërsa kur është ngjitur në katin e tretë dera ka qenë e hapur dhe atëherë e ka kuptuar se diçka nuk është në rregull pasi gjithmonë e mbyllin derën, në të gjitha dhomat, dhe kur ka hyrë në dhomën e fjetjes, dhoma ka qenë e tollovitur me rroba të hedhura në tokë. Tutje ka shtuar se kur ka parë dhomën në atë gjendje ka kontrolluar të gjitha vendet ku ka pasur arin dhe ka vërejtur se të gjitha kutit kanë qenë të hapura dhe të zbrazura, pra ari është marr nga ato, i cili edhe ka qenë dhuratë nga familja e burrit dhe e dëshmitares të cilat i janë blerë me rastin e martesës, ku sipas dëshmitares – të dëmtuarës vlera totale e arit arrin diku afër 10,000.00 Euro (dhjetëmijë Euro). Në fund ka shtuar se distanca nga garazha deri në ballkonin e katit të parë është 1.5 metra, ndërsa sipas asaj që ju ka treguar policia deri e ballkonit ka qenë e thyer. Lidhur me të pandehurin e njëjta ka deklaruar se nuk e njeh të njëjtin.

Marrja në pyetje e dëshmitarit E.LL., në seancën e datës 24.09.2024, i cili ka deklaruar se me datën 19.03.2021 kanë ardhur policia të cilëve edhe u'a ka dorëzuar DVR-in e kamerave. I njëjti po ashtu ka deklaruar se e njeh të pandehurin si fëmijë, si figurë, por të njëjtin nuk e ka parë në ditën kritike, por njëri nga të punëtorët e tij ka thënë edhe në prezencë të policëve se i pandehuri ditën kritike ka kaluar aty pari rreth shtëpisë së të dëmtuarëve.

Marrja në pyetje e të pandehurit B.M., në seancën e datës 24.09.2024, i cili ka deklaruar se me datën 13.03.2021 rreth orës 19:00 ka qenë jashtë Kosovës, dhe atë te bashkëshortja në Gjermani, ku ka qëndruar deri në muajin Gusht, ndërsa kufirin e Kosovës e ka kaluar me letërnjoftim, ndërsa kufijtë tjerë në mënyrë ilegale. I njëjti ka deklaruar se nuk i njeh të dëmtuarit dhe nuk e di se ku e kanë shtëpinë të njëjtit. Lidhur me saktësinë e deklaramit të të pandehurit gjatë marrjes në pyetje në Prokurori, ku kishte deklaruar me datën 15.01.2021 ka dal nga Kosova, ka shkuar në Austri, në mënyrë të ligjshme dhe atje ka qëndruar deri në Gusht të vitit 2021, i njëjti ka

deklaruar se ai deklaram nuk është saktë pasi që me datën 15.01.2021 ka qenë në paraburgim në Gjilan, ku i njëjti ka konfirmuar se në deklaratën e dhënë në Prokurori është nënshkrimi i tij dhe deklarata e dhënë në seancë është e saktë.

Provat materiale

Procesverbali për marrjen në pyetje të të dëmtuarit dëshmitarit E.M. i datës 23.03.2021; Procesverbali për marrjen në pyetje të të dëmtuarës dëshmitares Z.RR.M. i datës 13.03.2021; Raporti i oficerit Fahri Shala dhe Arton Hajra i datës 13.03.2021; Raporti i policës hetues Hajdin Hajrullahu dhe Bukurie Ferati i datës 13.03.2021; Raportet informuese hetimore të datës 13.03.2021 dhe 24.03.2021; Raporti i hetuesit i datës 15.03.2021; Raporti i oficerit Ali Caka i datës 13.04.2021; Përgjigja në kërkesën e Qendrën Kombëtare për Menaxhim me nr. 422/2023 e datës 30.10.2023; Vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara i datës 05.10.2021; Dosja e forenzikës së bashku me foto albumine datës 13.03.2021; Raporti i ekspertizës i ekzaminimit të pajisjeve të teknologjisë informative i datës 16.06.2021; Video incizimet e marra nga kamerat e sigurisë; Procesverbali i intervistimit të të pandehurit B.M. i datës 13.04.2021; Procesverbali për marrjen në pyetje të të pandehurit B.M. në PTH Mitrovicë, i datës 22.09.2023,

Gjetjet e gjykatës lidhur me faktet

Faktet jokontestuese

- Është fakt jo kontestues se me datë 13.03.2021 në rrugën “Bahri Beqiri” numër 24 në Vushtri është kryer një vjedhje e rëndë në shtëpinë e të dëmtuarit E.M.;

Ky fakt nuk është kontestuar nga palët. Përveç kësaj ky fakt vërtetohet edhe nga provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor që janë pjesë e kësaj lënde penale.

Faktet kontestuese

- Është fakt kontestues nëse i pandehuri B.M. ka qenë kryesi i kësaj veprë penale.

Ky fakt është kontestuar nga ana e të pandehurit përmes mbrojtësit të tij, gjatë gjithë shqyrtimit gjyqësor si dhe në fjalën hyrëse si dhe në fjalën përfundimtare.

Vlerësimi i provave nga gjykata

Gjykata pas prezantimit të provave, plotësisht dhe përtej dyshimit të bazuar, ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Këtë gjendje faktike, gjykata e vërtetoi në bazë të:

- Procesverbali i marrjes në pyetje në polici për të dëmtuarin E.M., i datës 23.03.2021 me të cilin vërtetohet se se me datën 13.03.2021 ka qenë në punë në KFOR, në Film City në Prishtinë, dhe diku rreth orës 20:15 është telefonuar nga bashkëshortja për tu njoftuar se në shtëpinë e tyre

kishin depërtuar hajnat dhe kishin tollovitur shtëpinë, ndërsa i njëjti pasi që ka marr leje nga mbikëqyrësi i tij është kthyer në shtëpinë e tij, ku me të mbërritur është takuar me Policinë e Kosovës të cilit kishin qenë duke kryer punën e tyre, ndërsa i njëjti ka vërejtur se në e tij dhe të nënës së tij kishin demoluar çdo gjë, ndërsa në dhomën e fëmijëve kishin kontrolluar një çantë të bashkëshortes së tij dhe pas përfundimit të punës nga policia e ka kuptuar se hajnat kishin marr të gjithë arin e bashkëshortes së tij, vlera e të cilit mund të arrinte shumën prej 7000 ose 8000 Euro. Tutje, i njëjti ka deklaruar se atë ditë nuk ka parë askënd të dyshimtë afër shtëpisë së tij, ndërsa me rastin e kryerjes së vjedhjes nuk kishte qenë askush në shtëpi, bashkëshortja e tij kishte qenë te familja e saj, ndërsa nëna e tij kishte qenë te vëllai të dëmtuarit, pasi që i njëjti ishte operuar. Në fund, i njëjti ka deklaruar nuk ka dyshim konkret në asnjë person.

- Procesverbali i marrjes në pyetje në polici për të dëmtuarën Z.RR.M., i datës 13.03.2021, me të cilin vërtetohet se me datën 13.03.2021, rreth orës 17:30 ka dal nga shtëpia dhe pas orës 19:30 është kthyer në shtëpi dhe ka vërejtur se dera e katit të tretë ishte e hapur dhe kur ka hyrë brenda (në katin e tretë) ka vërejtur se edhe dyert e dhomave të tjera kanë qenë të hapura. Tutje ka shtuar se e njëjta nuk ka prekur e as lëvizur asgjë dhe ka telefonuar familjarët të cilët pastaj kanë telefonuar policinë dhe duke zbritur për të dal jashtë, ka vërejtur derën e katit të dytë të hapur e po ashtu edhe derën e ballkonit të katit të dytë të hapur ashtu që vërehet se prej aty kanë depërtuar brenda në shtëpi dhe kanë dal po nga ajo pjesë. E njëjta ka theksuar se janë vjedhur sasi e konsiderueshme e stolive të arit të saj të cilat arrij vlerën rreth 7000 euro. duke shtuar se kanë vjedhur edhe një unazë të bashkëshortit në vlerë prej 150 Euro dhe diçka nga stolit e vjehrrës së saj me vlerë prej 2000 Euro dhe me përjashtim të arit nuk vëren se mungon diçka tjetër në shtëpi. E njëjta ka shtuar se dera e ballkoni të katit të dytë nuk është mbyllur me qelës dhe se e njëjta nuk ka dorëz për hapja nga jashtë. E njëjta në fund ka deklaruar se nuk ka dyshim konkret në asnjë person.

- Raportit të oficerit Fahri Shala dhe Arton Hajra, të datës 13.03.2021, ku përshkruhet se si me datën 13.03.2021, rreth orës 19:55 kanë marrë informacion nga ankuesja Z.. se në shtëpinë e saj ishte vjedhur sasi i konsiderueshme e arit ku këtë e kishte vërejtur pasi ishte kthyer në shtëpi rreth orës 19:30 (kur kishte dal nga shtëpia në ora 17:30), dhe me të hyrë në shtëpi kishte shkuar në katin tretë ku dera e salloni ishte e hapur ndërsa dhomat në pjesën lindore ishin demoluar e cila edhe ka theksuar vendin ku ka qenë ari, e cili mungonte. Pas shikimit të vendit të ngjarjes është arritur në përfundim se duke përdorur pullazin e garazhës afër shtëpisë, personat e dyshuar kishin depërtuar në ballkonin e katit të dytë, dera e së cilit kishte qenë e mbyllur, por që nga ana e ballkonit kushte dorezë për hapje. Sipas raportit të oficerit vlera e arit që ishte vjedhur, sipas ankueses kapte vlerën totale prej nëntëmijë e dyqind Euro (9,200.00 Euro).

- Raportit policor të policit hetues Hajdin Hajrullahu dhe Bukurije Ferati, të datës 13.03.2021, ku përshkruhet se si me datën 13.03.2021, rreth orës 20:10 janë njoftuar se për një rast të vjedhjes në Vushtri, dhe së bashku me policin e krim teknikës kanë shkuar në vendin e ngjarjes ku janë njoftuar nga ankuesja se e njëjta kishte dal nga shtëpia në ora 17:30 dhe me tu kthyer në shtëpi në ora 19:30 kishte vërejtur si dikush kishte hyrë në shtëpi. Sipas vendit të ngjarjes dyshohet se personat kishin depërtuar në shtëpi nga ballkoni i shtëpisë të cilin e kishin arritur nga muret e objekteve përcjellëse, ashtu që nga kati i dytë kanë kaluar në katin e tretë ku kishin demoluar

shtëpinë. Sipas këtij raporti ankuesja ka deklaruar se në shtëpi ishte vjedhur ari në vlerë totale prej nëntë mijë e treqind e njëzet Euro (9,320.00 Euro).

- Raporteve informuese të datës 13.03.2021 dhe 24.03.2021 ku përshkruhet deklarimi i të dëmtuarës se si e kishte gjetur shtëpinë kur ishte kthyer në shtëpi rreth orës 19:30, pra me dyert e dhomave të hapura, dhomat e demoluara, pasi që të gjitha rrobat ishin hedhur në tokë, dyert e dollapëve të hapura si dhe mungesën e një sasive të konsiderueshme të arit që ishte vjedhur nga shtëpia dhe pastaj kishte njoftuar policinë. Po ashtu në këto raporte përshkruhet se si është fotografuar dhe ekzaminuar vendi i ngjarjes, se si kishin depërtuar personat e dyshuar brenda shtëpisë, dhe atë përmes garazhës që gjendet ngjitur me shtëpinë, përmes ballkonit të katit të dytë, ku dera e ballkonit hapej me pak mundin nga ballkoni edhe pse nuk kishte dorezë për hapje nga ajo anë. Tutje në raportin informues të datës 24.03.2021 përshkruhet se si në Autolarjen “Mema” që ndodhet përball vendit të ngjarjes kanë evidentuar 2 kamera të sigurisë, ku pas kontaktimit me pronarin e autolarjes, i njëjti vullnetarisht ka ofruar qasje në DVR-in, *ku gjatë shikimit janë vërejtur 2 persona duke dal nga rruga që shpinte tek shtëpia e të dëmtuarit, ku gjatë shikimit njëri nga punëtorët kishte deklaruar se pas përfundimit të punës rreth orës 19:00, duke shkuar në banesën e tij që gjendej afër vendit ku ka ndodhur vjedhja, në hapësirën para banesës së tij, kishte parë, tani të pandehurin B.M., ku sipas këtij punëtori, të njëjtin e njej shumë mirë, dhe sigurt e di se ka qenë ai (pra B.M.) sepse para disa vitesh kishte pasur kontakte me të dhe të njëjtin e njej si person që kryen vepra të ndryshme, dhe me siguri të plotë kishte deklaruar se njëri nga dy personat që shihet në video incizimet ishte tani i pandehuri B.M..*

- Përgjigja e Qendrës Kombëtare për Menaxhim Kufitar numër 422/2023, e datës 30.10.2023 me të cilën vërtetohet se personi me emrin B.M. për periudhën prej 01.01.2021 deri me 01.10.2023, me numër personal ..., dhe numër të letërnjoftimit ... kishte dal nga Republika e Kosovës me autobus, në pikën kufitar në Vermicë, me datën 08.03.2021 në ora 23:19:41, ndërsa kishte hyrë në Republikën e Kosovës, me autobus, në pikën kufitar në Vermicë me datën 09.03.2021, në ora 21:32:42.

- Dosja e Forenzikës, së bashku me raportin e këqyrjes së vendit të ngjarjes në të cilin përshkruhet se si kryesit dyshohet të kenë përdorë garazhën e cila është afër ballkonit e që dyshohet se është shfrytëzuar nga për të depërtuar në ballkonin e katit të dytë prej nga edhe kanë hyrë brenda shtëpisë. Po ashtu përshkruhet edhe gjendja e katit të tretë të shtëpisë ku në dhomën e fjetjes, në anën e majtë të shtëpisë janë evidentuar rrobat dhe gjësendet e ndryshme të shpërndara në dysHEME ku mbi shtrat kishte paketime të ndryshme të stolive të arit, të zbrazura, ndërsa në dhomën tjetër të fjetjes në anën e djathtë të shtëpisë janë evidentuar dollapët e hapur me gjësende të ndryshme në dysHEME. Po ashtu në këtë dosje është bashkangjitur edhe fotoalbumi ku shikohet shtëpia nga jashtë, shtëpia brenda, ballkoni, dhe dera e të njëjtit prej nga dyshohet se është depërtuar brenda, garazha e cila dyshohet se është përdorur për tu qasur në ballkonin e katit të dytë të shtëpisë, pastaj shkallët që dërgojnë në katin e tretë, dhe dy dhomat e fjetjes në të cilat shihen rrobat dhe gjësendet e tjera të hedhura në dysHEME.

- Raporti i ekspertizës i ekzaminimit të pajisjeve të teknologjisë informative i datës 16.06.2021, në të cilën janë ekstraktuar informacionet e nxjerra nga telefoni Samsung A71 me IMEI

- Video incizimet nga Autolarje “Mema” ku në ora 19:20:58 vërehen dy persona duke dal nga rruga e cila shpie te shtëpia e të dëmtuarit – vendit ku është kryer vjedhja, e që nga punëtori i Autolarjes, njëri nga ta identifikohet me siguri të plotë B.M..

- Procesverbali i marrjes në pyetje në polici për të dyshuarin B.M., i datës 13.04.2021 në të cilën i njëjti ka shfrytëzuar të drejtën e tij për tu mbrojtur në heshtje.

- Procesverbali i marrjes në pyetje në prokurori për të dyshuarin B.M., i datës 22.09.2023 në të cilin ka deklaruar se me sa i kujtohet me datën 15.01.2021 ka dal nga Kosova dhe ka shkuar në Austri në mënyrë të rregullt, ku e ka kaluar kufirin në Merdare me autobusin “Barileave Turist” dhe ka vazhduar menjëherë për në Gjermani të bashkëshortja dhe djali i tij, ku atje ka qëndruar deri në muajin Gusht të vitit 2021 kur edhe ka ardhur për pushime në Kosovë, serish me autobusin e firmës së njëjtë, pastaj me vendim të Gjykatës Themelore Prishtinë, ka qëndruar në paraburgim për dy muaj për një vepër tjetër penale dhe është liruar, ndërsa prej datës 27.11.2021 e gjer në ditën e marrjes në pyetje në prokurori ka qenë në vuajtje të dënimit sipas vendimit të Gjykatës Themelore Mitrovicë – Dega Vushtrri për një vepër tjetër penale ndërsa telefonin që i është konfiskuar, të njëjtin e ka pasur me vete sa ka qenë në Gjermani.

Për gjykatën deklarata e të dëmtuarit E.M. dhe Z.RR.M., me rastin e marrjes në pyetje gjatë shqyrtimit gjyqësor ishte konsistente, e plotë dhe bindëse e cila ishte në harmoni edhe me deklaratimet e tyre me rastin e marrjes në pyetje në polici. Si atëherë edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor tani, të njëjtit kanë qenë konsistent në deklaratimet e tyre lidhur me ngjarjen, gjendjen e shtëpisë, mungesën e stolive të arit etj, për këto arsye edhe gjykata u’ a fal besimin në tërësi deklarimeve të tyre, duke i vlerësuar të njëjtat si bindëse Po ashtu të bazuara edhe në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Nga raportet policore duke përfshirë edhe raportet informuese, në të cilat është dhënë përshkrim i hollësishëm i veprimeve policore e hetimore e po ashtu edhe nga dosja e forenzikës në të cilat përshkruhet vendi i ngjarjes e shihen edhe fotot e bërë në vendin e ngjarjes, gjykata, pa asnjë mëdyshje është bindur se një vepër penale është kryer, dhe atë vepra penale e vjedhjes së rëndë.

Nga raporti i ekspertizës i ekzaminimit të pajisjeve të teknologjisë informative i datës 16.06.2021, nga të dhënat e ekstraktuara nuk është gjetur asnjë indikacion se me datën 13.03.2021, Telefoni Samsung A71, pronë të pandehurit ka qenë i lokalizuar jashtë territorit të Republikës së Kosovës.

- Nga përgjigja e Qendrës Kombëtare për Menaxhim Kufitar numër 422/2023, e datës 30.10.2023 gjykata ka vërtetuar se i pandehuri B.M. brenda periudhës prej 01.01.2021 deri me 01.10.2023, ka dal nga Republika e Kosovës vetëm njëherë dhe atë me datën 08.03.2021 në ora 23:19:41, me autobus, përmes pikës së kalimit kufitar në Vërmicë ka dal nga Kosova, ndërsa me datën 09.03.2021, në ora 21:32:42, me autobus, përmes pikës së kalimit kufitar në Vërmicë kishte hyrë në Republikën e Kosovës.

- Nga kamerat e sigurisë të marra nga Autolarja “Mema” që gjendet përball vendit ku është kryer vepra penale, është vërtetuar se me datën 13.03.2021, në ora 19:20:58, shihen dy persona duke dal nga rruga që shpie për te shtëpia ku ka ndodhur vjedhja, ndërsa është vërtetuar se njëri nga ishte B.M. , pasi që i njëjti ishte identifikuar me siguri të plotë nga punëtori i po asaj autolarje gjatë shikimit të video incizimeve i cili edhe kishte deklaruar se të pandehurin atë ditë rreth orës 19:00 e kishte parë në afërsi të shtëpisë ku është kryer vjedhja.

Për gjykatën, deklarata e të pandehurit B.M. me rastin e marrjes në pyetje gjatë shqyrtimit gjyqësor ishte jo konsistente, jo e plot dhe jo bindëse, dhe kishte për qëllim mundësimin e shmangies nga përgjegjësia penale për të pandehurin, pasi që i njëjti me rastin e deklarimit në prokurori me datën 22.09.2023 kishte deklaruar se me datën 15.01.2021 kishte dal nga Kosova në mënyrë të ligjshme dhe nuk ishte kthyer në Kosovë deri në Gusht të vitit 2021, ndërsa gjatë deklarimit në shqyrtim gjyqësor i njëjta ka thënë se me datën 15.01.2021 ka qenë në paraburgim në Gjilan, ndërsa me datën 13.03.2021 nuk ka qenë në Kosovë dhe nga Kosova ka dal në mënyrë legale, ndërsa kufijtë tjerë i ka kaluar ilegalisht duke shkuar në Gjermani te bashkëshortja dhe djali i tij dhe se telefonin i cili i është konfiskuar, e ka pasur me vete gjatë kohës së qëndrimit jashtë Republikës së Kosovës

Deklarimit të mësipërm gjykata nuk i’ a fali besimin pasi që ky deklarim është në kundërshtim me provat e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku pa asnjë mëdyshje është vërtetuar se i pandehuri jashtë Republikës së Kosovës ka qenë vetëm nga data 08.03.2021 deri me datën 09.03.2021, ndërsa nuk ka paraqitur as edhe një provë të vetme me të cilat do të mund të argumentonte se përnjëmend ka qenë jashtë Kosovës në kohën kur është kryer vepra penale,

Për gjykatën, nuk ekziston asnjë mëdyshje se i pandehuri me dashje ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë me aktakuzën e Prokurorisë Themelore Mitrovicë, dhe nga të gjitha provat e administruara më sipër del se i pandehuri, përveç se është parë në afërsi të vendit ku është kryer vepra penale, i njëjti është identifikuar edhe përmes kamerave të sigurisë të marra në afërsi të vendit ku është kryer vepra penale. Për më tepër i pandehuri nuk ka arritur që të prezantoj alibi të qëndrueshme për vendndodhjen e tij në kohën e kryerjes së veprës penale, pra nuk ka qenë në gjendje që në mënyrë të besueshme apo të ofroj prova se i njëjti në kohën e kryerjes së veprës penale nuk ka qenë në Republikën e Kosovës.

Kjo gjykatë, konsideron se përtej çdo dyshimi të bazuar, është vërtetuar plotësisht gjendja faktike, si në dispozitiv të aktgjykimit dhe se në veprimet e të pandehurit të, manifestohen të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 315, paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 të KPRK-së.

Rikualifikimi i veprës penale

Dispozitat relevante materiale dhe procedurale;

Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë për veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 paragrafi 2, nën paragrafi 2.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP.II.nr.835/21, të datës 08.12.2023.

Gjyqtari i vetëm gjykues i ka vlerësuar pretendimet e prokurorisë në raport me përshkrimin faktik të ngjarjes, provave që janë deponuar, provave që janë administruar në shqyrtim gjyqësor të gjitha këto nga gjykata janë vlerësuar në raport me nenin 359 të KPPK-ës. Bazuar në nenin 359 par 2 të KPPK-së, *“Gjykata nuk detyrohet me propozimet e prokurorit të shtetit lidhur me kualifikimin ligjor të veprës penale”*.

Gjyqtari i vetëm gjykues, në këtë çështje penale ka bërë rikualifikimin e veprës penale sa i përket paragrafit dhe në vend të paragrafit 2 nën par 2.1 të KPRK-së të nenit 315, në paragrafin 1 nën par 1.1 të nenit 315, dhe atë sa i përket pjesë së dispozitivit ku përcaktohet vlera e dëmit, pasi që për gjykatën nuk kishte prova të mjaftueshme sa i përket vlerës së dëmit, rrjedhimisht gjykata vlerëson se në këtë çështje penale janë përmbushur të gjitha elementet e veprës penale vjedhje e rëndë nga neni 315 par 1 nën par 1.1 të KPRK-së, duke marrë parasysh faktin se i pandehuri ka depërtuar me forcë në hapësirë të mbyllur duke tejkuluar pengesat dhe duke marrë pasurinë e luajtshme të personave tjerë dhe atë në mënyrë të kundërligjshme me qëllim të përfitimit pasuror, mirëpo në këtë rast nuk është vërtetuar, respektivisht prokurori i shtetit dhe palët e dëmtuara nuk kanë arritur të sigurojnë prova të mjaftueshme me të cilat do të vërtetohej se dëmi i shkaktuar është mbi pesmijë (5,000 €), e i cili dëm edhe është element determinus në raport me kualifikimin juridik të veprës penale, andaj gjykata në mungesë të provave sa i përket dëmit mbi 5,000 (pesëmijë) euro, bëri rikualifikimin e veprës penale, nga neni 315 par. 2 nën par. 2.1 të KPRK-së, në nenin 315 par. 1 nën par. 1.1 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues, në përshkrimin faktik nuk ka ndryshuar identitetin subjektiv të veprës penale, nuk ka ndryshuar përmbajtjen esenciale të akuzës në raporte me kohën, vendin, të pandehurin, përveç se ka ndryshuar rrethanat cilat i ka provuar në shqyrtimin gjyqësor.

Gjyqtari i vetëm gjykues e ka përshkruar gjendjen faktike ashtu siç është vërtetuar me provat e administruara në shqyrtimin gjyqësor.

Mbi bazën e provave gjyqtari i vetëm në këtë aktgjykim ka dhënë arsye të mjaftueshme për secilin fakt të vërtetuar. Sipas vlerësimit të gjykatës kjo situatë është e rregulluar me nenin 359 par.2 dhe 360 të KPPK-ës.

Gjyqtari i vetëm gjykues duke u bazuar në dispozitën e neni 359 par.2 të KPPK-ës, e cila dispozitë nuk e detyron gjykatën me propozimin e prokurorisë lidhur me kualifikimin juridik të veprës penale, në këtë rast ka ndryshuar respektivisht ka bërë ri kualifikimin juridik të veprës penale.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Gjykata lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit ka pasur parasysh vlerësimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së. Si rrethana lehtësuese në raport me të pandehurin gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti është i gjendjes së dobët ekonomike, si dhe moshën e re në kohën e kryerjes së veprës penale, ndërsa si rrethana rënduese për të pandehurin gjykata ka gjetur, shkallën e përgjegjësisë penale, intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, faktin se i pandehuri ka qenë edhe më parë i gjykuar për vepra penale të vjedhjes së rëndë dhe vepra penale të vjedhjes, i gjykuar me aktgjykimet e plotfuqishme dhe atë: aktgjykimin P.nr.70/2019 të datës 15.03.2019 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, aktgjykimin P.nr.104/2019 të datës 22.07.2019 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, aktgjykimin P.nr.462/2021 të datës 26.01.2023 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, aktgjykimin P.nr.166/2022 të datës 11.01.2024 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, aktgjykimin P.nr.361/2021 të datës 10.06.2024 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Dega në Vushtrri, aktgjykimin P.nr.2140/2021 të datës 23.02.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë, si dhe aktgjykimin P.nr.30/2021 të datës 14.06.2021 të Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Istog.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se shqiptimi i këtyre dënimeve ndaj të pandehurit është i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë të të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se me këto dënime do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin për udhëzimin e palës së dëmtuar E.M. dhe Z.RR.M. në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike lidhur me këtë çështje penale, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPK-së, ku është përcaktuar se: “Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil”, pasi që i dëmtuari nuk i ka ofruar gjykatës ndonjë dëshmi në lidhje me dëmin material dhe jo material të pësuar nga kjo vepër penale.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par 2 nën par 2.6 dhe 2.8 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj gjykata duke u bazuar me neni 358, 364, 449, 462 të KPPK-ës nga arsyeje e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE MITROVICË – DEGA VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.329/23, datë 26.09.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.